REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/ 225
Datë: 10.05.2022

PROCESVERBAL

i mbledhjes së dytë (II) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND I DITËS

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së- II- të jashtëzakonshme datë: 25.01.2022.
2. Miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
3. Miratimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2022.
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale Janar-dhjetor 2021.
5. Shfuqizimi i vendimit nr.02/452 datë: 22.07.2019 në lidhje me kërkesën nr.01/386 datë:14.03.2022, të parashtruar nga Kryetari i komunës për marrjen e vendimit, për ndërrimin e pronës publike në pronë private, për interes publik me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorc KK-Malishevë.
6.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/386datë: 14.03.2022, për marrjen e vendimit, për ndërrimin e pronës publike me pronë private, për interes publik me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorc KK-Malishevë.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesëës së Kryetarit të Komunës nr.01/387 datë:14.03.2022, për marrjen e vendimit për dhënien në shfrytëzim në afat prej dy vitesh, të Pishinës Publike në fshatin Banjë, KK-Malishevë.
8. Formimi i komisionit vlerësues, për dhënien në shfrytëzim në afat prej dy vitesh, të Pishinës Publike në fshatin Banjë, KK-Malishevë.

9. Njoftim lidhur me Raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2021.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.05/94 datë:16.03.2022, të Drejtorisë për Urbanizëm për ndryshimin e segmenteve të rrugëve lokale në fshatin Kijevë.
11.Miratimi i Draft-Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komuës.
12. Shqyrtimi i Planit të punës të Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2022.
13. Formimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve në Komunën e Malishevës.
14.Themelimi i komiteteve jo obligative:
-Komiteti për Arsim dhe Kulturë
-Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara
-Komteti për Familjet e Dëshmorëve,Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës
-Komiteti për Diasporë
-Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Turizëm, Mbrojtje të Mjedisit dhe monitorim të projekteve publike
-Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
15. Shqyrtimi i Raportit të Kompanisë "Hidroregjioni Jugor" Njësia në Malishevë për vitin 2021.
16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/40 datë:04.02.2022 të parashtruar nga z.Ali A.Morina nga fshati Sferkë KK-Klinë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/53 datë:21.02.2022 të parashtruar nga z.Alban M.Bytyçi nga fshati Shkozë KK.Malishevë, për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.05.80 datë:10.03.2022 të parashtruar nga z.Ahmet G.Mazreku nnga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
19. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06.70 datë:10.03.2022 të parashtruar nga z.Shefqet A.Halitaj nga fshati Senik KK-Malishevë për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06.55 datë:24.02.2022 të parashtruar nga z.Fehmi I.Krasniqi nga fshati Carrallukë KK-Malishevë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
21. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 29.03.2022 dhe filloi në ora: 10:15. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 25 asambleistë, drejtorë komunal përfaqësues nga Kfori Zvicëran, përfaqësues nga OSBE-ja dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!
Prezent në sallë janë 25 asambleistë, kuorum kemi dhe mund të vazhdojmë seancën. Kemi 30min në dispozicion për pikat jashtë rendit të ditës. Dua ta ngris një shqetësim si Kryeses, në lidhje me seancën solemne të mbajtur me 5, 6 dhe 7 mars për nder të Epopesë së UÇK-së, lidhur me mos pjesëmarrjen dhe bojkotimin e pothuajse të 2/3 e antarëve të kuvendit. Kjo nuk i bënë nder as Kuvendit dhe as neve si të zgjedhurit e popullit. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Përshëndetje për të gjithë!
Një çështje që do e ngris është te zjarret, është mirë këto zjarre të kenë kontrollen dhe menaxhimin. Sa u përket mbeturinave, e kemi ngritur dhe në seancat e kaluara që mbeturinat duhet të pastrohen, sepse shumë njerëz kanë shkaktuar probleme të mëdha me djegien e mbeturinave dhe pastaj po vazhdon ajo djegie dhe në male. Drejtor, kisha kërkuar një angazhim më të madh prej teje.
Kryesues, pse po ndodh vonesa e seancave nga 50 min? Seanca është në ora 9 e 30 dhe grupi jonë po është prezent me orar, sepse për 30 mund t'i përfundojmë një ose dy pika.
Kryesues, është mirë që ne sot të marrim një vendim për çështje të materialit, a do shkojmë në këtë formë, a do shkojmë me material fizik apo do na pajiseni me llaptop, sepse po vjen shumë keq.

Argjend Thaçi: Është e vërtet që grupi juaj po është prezent me orar në mbledhje dhe ju bëjë thirrje dhe grupeve tjera ta respektojn thirrjen e seancës. Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!
Çështja e ujësjellësit nëpër fshatrat në komunën e Malishevës-cilët janë hapat që i ka bërë ekzekutivi, konkretisht kryetari, sidomos në çështjen që është proglamuar për ujsejllësin në lidhje me Gjakovën dhe disa punime të ujësjellësve ekzistues që janë duke u bërë, dua ta di se deri ku kanë shkuar ato punime. Ka pasur shumë petincione të fshatrave për çështjen e ujësjellësit. Një prej tyre të cilën nuk e keni sjellur as në kuvend është çështja e peticionit të ujësjellësit të Panorcit, ku janë shpenzuar afro gjysmë milion euro dhe banorët e Panorcit nuk kanë ujë të pijes. Një shqetësim tjetër të banorëve për shkak të punimeve që janë duke u bërë, te lagjja Sertolli kërkojnë të vendoset urë dhe jo gypa, që mos të ketë probleme në të ardhmen.
Një shqetësim tjetër është te prona e shkollës në fshatin Goriq. Diqka të ngjajshum ka pasur dhe në çështjen e Drenovcit me sa di rrethoja e shkollës ka disa vite që nuk ka mundur me u përfundu dhe sa jam e informuar prej banorëve janë pikërisht kontestet pronësore. Besoj drejtori na shpjegon këto.
Çështja tjetër është materiali i antarëve të kuvendit. Si do bëhemi pjesë e debatit në seancë, kur

ne nuk kemi material dhe në mënyrë elektronike nuk vërehet shumë. Kryesues, ushtroje detyrën për të cilën e ke marrë.

Argjend Thaçi: Materiali ka ardhur në mënyrë elektronike, po ashtu dhe kopjet fizike i keni afër. Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë!
Unë e mora fjalën me kërkesë të kryetarit z.Ekrem Kastrati, i cili nuk mund të merr pjesë në senacë. Kryetari ka një takim për një interes shumë të madh me përfaqësuesit e Kforit Italian, sepse institucionet e qeverisë së Italis me disa hulumtime dhe statistika që i kanë bërë ka dalur që rajoni i komunës sonë e ka numrin më të madh të të rinjëve të mitur nën moshën 18 vjeçar që emigrojnë në Itali dhe për ta ky është një shqetësim i madh. Besoj se dikush prej ekzekutivit do na japin përgjigjje në lidhje me shqetësimet që i kemi ne.
Labi e ngriti çështjen e ujit dhe me të vërtetë uji është një shqetësim kogja i madh sivjet, sepse nivelet e ujrave kanë rënë shumë. Qeveria komunale me aq sa kam pasur kontakt unë, nuk është duke u treguar neglizhente ndaj kësaj çështje, veq ka filluar procedurat pqë të krijojë një taks forcë, ku do përfshihen të gjitha institucionet që të merren me çështjen e ujit. Më lehtë është që ky vit me u shpallë si vit emergjent për shkak të ujit dhe me i vnu në dispozicion të gjitha burimet tona të brendshme që i kemi dhe kur neve na sosen burimet e brendshme, të përpiqemi dhe me Radoniqin që t'i zgjedhim, sepse uji është gjëja më e domosdoshme.
Shqetësimi me materialin në shumicën e rasteve është i arsyeshëm. Meqenëse tani është e pamundur shpërndarje e materiali dhe secili prej nesh një material që është më i rëndësishëm mundemi dhe me printu.

Argjend Thaçi: Urdhëro,Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!
Dhe unë e ndaj shqetësimin për seancat solemne në mos pjesmmarjen e shumicës së asambleistëve, sepse nuk i bëjnë nder kuvendit. Në senacës solemne të 17 shkurtit nuk e di ku është Agroni përgjegjësi IT, unë ju kisha lutur me i marr të gjitha masat që nëse nuk i punojnë paisjet këtu, të kërkoj ndihmë nga kryetari që të mundësohet rregullimi i këtyre paisjeve.
Kisha një çështje për Drejtorin e Shëndetësisë, mirëpo ai nuk qenka këtu. Prej mjekëve të repartit të stomatologjisë në QKMF-ë më kanë informuar se nuk ka anestezion prej muajit maj të vitit 2021. Pacientët detyrohen me dalë në barnatore private me i ble, për me i kry shërbimet brenda në këtë repart. Ne ndajm buxhet çdo vit për barnat esenciale në QKMF dhe është absurde mos mu furnizu kjo qendër.
Prej shumë qytetarëve kam informacion që reparti i radiologjisë në QKMF punonë me kapacitet gjysmak ose kryen fare pak shërbime brenda dite. Doktorresha, specialistja e kësaj fushe me arsyetimin se nuk i lejohet për më shumë se 6 pacientë t'i trajtojë për shkak të rrezatimit, pra nuk i trajton ata pacient që shkojnë pas numrit 6. E njëjta ka laboratorin privat dhe atje trajton me dhjeta pacient. Nëse e njëjta nuk ka të drejtë t'i trajtojë më shumë se 6 pacientë brenda ditës, si mundet në ordinanc privati t'i trajtoj dhe shumë pacient të tjerë.

Largimi i bilbordave të qytetit-Është një vendim i kuvendit të legjislaturës së kaluar para dy viteve, për largimin e bilbordave në qytetin e Malishevës. Këta bilborda janë të vendosur ilegalisht. Meqenëse është vendimi i kuvendit unë mendoj që ata bilborda duhet të largohen ose kjo na detyron të ngrisim padi ndaj drejtuesve, ndaj komunës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëlinda!

Mirëlinda Gashi: Përshëndetje për të gjithë!
Unë do ndalem të çështja e transportit të udhëtarëve. Disa kompani te mujoret e nxënësve më nuk po shkojnë me mujore, por me mjete kesh, nxënësit tanë obligohen të paguajnë nga 1E që të vinë deri në Malishevë dhe 1 E që të kthehen në shtëpitë e tyre. Nuk e di komuna sa mundet me ndiku në atë pjesë, mirëpo kërkoj nga kompanitë e transportit të shkojnë me ulje të çmimit për nxësit tanë. Mos të kategorizohen si nxënësit që udhtojnë çdo ditë, si qytetarët.
Një pytje për kryetarin e komunës, pse ka marrur vendime ku disa zyrtar që janë me vite që punojnë në komunë ju është ndërruar vendi i punës. Ne kërkojmë një përgjigjje nga kryetari.
Një shqetësim tjetër është për Drejtorin e Arsimit. Ne kemi parë që drejtoresha e ka bërë një foto dhe e ka vendosur në facebook, aty shkruan që është ndaluar pagesa e disa drejtorëve të cilët nuk janë paraqitur ose nuk janë gjetur në vendin e punës. Unë kërkoj nga drejtoresha e Arsimit le të del me iniciale të atyre drejtorëve, të na sjellin këtu që vërtetë drejtoresha e ka bërë atë veprim.
Çështja e materialit është ardhur në email, ka material që nuk vërehet mirë, mirëpo Kryesues këtë material që ne e kemi gjetur tani këtu, është mirë me na dërgu në adresat që ne i kemi ofruar dhe nuk ishte bërë ky debat për materialin, derisa të pajisemi me llaptop.

Argjend Thaçi: Urdhëro,Valon!

Valon Mazreku: Faleminderit, Kryesues! Përshëndetje për të gjithë!
Kryesues, unë e kam rendin e ditës dhe i kam 4 kërkesa që nuk figurojnë si pika në rendin e ditës. Nuk e di si e keni menduar se do të trajtohen këto kërkesa, fjala është për 4 familjet të cilat kanë bërë kërkesa për dëme të zjarreve dhe kanë kërkuar mbështetje. Që të marrim vendim për këto kërkesa duhet të jenë në rend të ditës dhe kisha kërkar që këto të futen në rend të ditës.
Unë kam dhe një kërkesë tjetër sa i përket Komisionit të Aksionarëve, që të futet në rendtë ditës zëvendësimin e një antari të këti komisioni.
Sa i përket çështjeve mjekësore dhe furnizimeve mjekësore në këtë rast me anestezion, këto janë furnizime ose mjete të cilat duhet të furnizohen nga Ministria e Shëndetësisë. Ka raste kur ne kemi blerë vetëm si komunë për shkak mos me i lënë keq shërbimet që ofrohen aty.
Sa i përket transportit të nxënësve, ju jeni dëshmitar se ka një jo stabilitet të madh të çmimeve dhe ne kemi informacion që ka pasur një ndryshushmëri të çmimit, jo që ka marrur kosto shtesë për ditët e rregullta të mësimit, janë disa shkolla që është dashur të ju bëhet transporti që kanë me zëvendësu mësimin gjatë ditëve të shtuna, atëherë për ditët e shtuna kanë marrur ekstra pagesë.

Argjend Thaçi: Urdhëro,Valon!

Valon Krasnqi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!
Kryesues, unë kam një kërkesë për ty, që në sallën e kuvendit të vendoset fotografia e Presidentes së Republikës së Kosovës znj.Vjosa Osmani.

Argjend Thaçi: Në zyrën time është e vendosur fotografia e Presidentes, mirëpo do mundohemi dhe në sallën e kuvendi të vendoset. Kalojmë te rendi i ditës. Urdhëro Halil!

Halil Morina: Ne si grup kërkojmë që të futet si pikë e rendit të ditës, zëvendësimin e një antari në Komisionin e Aksionarëve, zëvendësimin e Jahir Xhyliqit.

Argjend Thaçi: Te pika 13 kemi formimin e komisionit për emërtimin e rrugësve në komunën e Malishevës dhe neve na duhet formimi i komisionit për ankesa, e që nuk e kemi në rend të ditës. Unë propozoj, që formimi i komisionit për ankesa, të hyjë në rend të ditës. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Kryesues, ndoshta është mirë që t'i me hapë debatin për rend të ditës dhe pastaj ka kërkesa për futje në rend të ditës dhe për largimin të pikave nga rendi i ditës. Kërkesat që dalin për vendosje në rend të ditës, votohen.

Argjend Thaçi: Hapi debatin për rendin e ditës. Urdhëro,Nebih!

Nebih Bibaj: Për rendin e ditës e kam një kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr.02/452 pika e 5 për shkollën e fshatit Panorc, unë mendoj që duhet të largohet nga rendi i ditës, sepse ne ende nuk e kemi një vendim të qartë prej organeve të drejtësisë në formën e shkruar, që ne të shkojmë me tutje. Unë ju bëjë thirrje antarëve të kuvendit që përderisa neve nuk na vjen një vendim nga organet e drejtësisë, që është një vendim i përfunduar, ne nuk do të shkojmë tutje. Kurdo që vjen vendimi i përfunduar, ne jemi të gatshëm ta përfundojmë atë proces.
Kryesues, një kërkesë tjetër është formimi i komisionit për hartimin e rrugëve në komunën e Malishevës. Unë kam qenë mandatin e kaluar dhe ky komision e ka kry punën e vet si komision, janë përmbledhur, janë shqyrtuar kërkesat e të gjitha vendimeve. Nuk kemi nevojë për një komision të tillë, sepse komisioni e ka përfunduar punën e vetë në mandatin e kaluar. Unë kërkoj që pika 13, të largohet nga rendi i ditës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Kryesues, sa i përket pikës së 13 dhe kërkesës që ju e kërkuat, a duhet me qenë komisioni i ankesave i veçantë, vetëm për ankesat që vinë për emërimin e rrugëve, sepse ne mbledhjen e kaluar e kemi themeluar një komision të ankesave dhe ai komision a e ka mandatin dy vjeçar, apo formohet komision i veqantë.

Argjend Thaçi: Ai është komision i ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave, ndërsa ky është për emërtimin e rrugëve, janë komisione të veçanta. Urdhëro, Astrit!

Astrit Sertolli: Përshëndetje për të gjithë!
Para se mu ndërlidhë me pikat e ditës, e falënderoj Labinotin që i përmendi punimet që po bëhen

te lagjja Sertollëve. Gati 3 ditë Drejtoria e Urbanizmit, bashkë me inxhinjerët janë duke u marrë me atë pjesë dhe besoj se do bëhet një punë shumë e mirë dhe ka me lehtësu qasjen e qytetarëve përkatësisht të asaj lagje për lokacionin e ri të varrezave.
Sa i përket rendit të ditës, kisha kërkuar që te formimi i komiteteve jo obligative, si grup kemi kërkesë që Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër,Turizëm, mbrojtje të mjedisit të zëvendësohet me Komitetin për Barazi Gjinore.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Faleminderit, Kryesues!
Sa përket rendit të ditës e shpreha shqetësimin te çështja e materialit, mirëpo tani po na vinë dhe pika të reja që të hynë në rend të ditës, nuk po më doket e arsyeshme, nuk e di pse gjithë kjo nguti.
Te çështja e kërkesës për shkollën në Panorc, ne si antarë të kuvendit është dashur ta kemi vendimin e gjykatës.
Në vitin 2016 komisioni për emërtimin e rrugëve e ka përfunduar punën dhe për shkak të tekeve dhe numrave si po sillen dhe sot, për një emër të një rrugë gjithë puna e komisionit nuk ka kaluar. Nuk e di çfarë komisioni do të bëjë, nëse dojnë me hy në një proces të ri, sepse ne kemi me hapë dhe shumë probleme tjera. Meqenëse nuk ka kaluar emërtimi i rrugëve është bërë komisioni për shqyrtim të ankesave dhe ai e ka kryer punën, mirëpo nuk e di pse është neglizhuar kaq lehtë. Prej agjensionit kadastral nëse nuk gaboj, na është thënë që procesi i emërtimeve të rrugëve dhe ankesave përfundon deri në 5 vite. Tani nuk po e di sakt çfarë komisioni po doni. Nëse është në pytje për një rrugë që ka pakënaqësi, të cilën na si legjislatur e kaluar i kemi trajtuar veq e veq. Është mirë kur të na vjen materiali me ditë çka po dojm me ba me na ardhë një raport nga legjislacioni i kaluar, sepse atëherë komisioni nuk ka pasur vërejtje në përjashtim emrin e një rrugë në qytezen e Malishevës. Nga emri i asaj rruge ka rënë puna e komisionit që NISMA në atë kohë nuk e ka kaluar. Nuk e di çfarë rrugë tjera kemi me emërtu, kur ai proces është i mbyllur dhe komisioni i ankesave e ka kryer punën e vetë.
Sa i përket rendit të ditës unë po propozoj që kjo seancë të shtyhet për shkak të mungesës së materialit, sepse materiali nuk lexohet. Unë kërkoj që propozimi për shtyrje të seancës të hudhet në votim.

Argjend Thaçi: Urdhëro,Veton!

Veton Zogaj: Kërkesën për shkollën e Panorcit e kemi diskutuar dhe në KPF-ë, mirëpo sot vendimi që ka ardhur bashkë me një kërkesë, nuk ka qenë aty dhe më bëri përshtypje shumë. Është vendimi të cilin e ka marrur legjislatura e kaluar që kjo kërkesë për ndërrim destinim të pronës mos me ardhë në kvend deri sa nuk e kemi një vendim të gjykatës. Pra, po kërkohet me u shfuqizu ai vendim. Unë mendoj që ky vendim nuk duhet të shfuqizohet sot, sepse ta kemi një vendim të gjykatës dhe pastaj e sjellë kryetari ose shkon në KPF-ë dhe pastaj në kuvend që ta shqyrtojmë. Këroj që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës.
Kryetari e as nënkryetari nuk janë prezent këtu dhe mendoj që dhe raporti i kryetarit të shtyher

për seancën tjetër.
Komisioni që e ka draftu rregulloren për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Këtë e kemi diskutuar me Muharremin në KPF-ë ka ardhur si kërkesë e Asosacionit dhe e ka draftu. E kam lexuar draftin e parë dhe aty i kam marrur arsyetimet që nëse kuvendi merr vendim për nxjerrjen e rregulloreve dhe draftimit të t'i unë mendoj që dhe kuvendit i takon me bërë një komision të vetin të profesionistëve të fushës juridike, që ta shqyrtojë këtë draftin që e ka përgaditur ky komision.

Argjend Thaçi: Urdhëro,Valon!

Valon Krasniqi: Sa i përket kësaj pike që jemi duke e diskutuar për rend të ditës, unë kam një sugjerim nga përvoja apo praktika e legjislaturës së kalar, te pikat e fundit të rendit të ditës duke marrur parasysh që ndonjëherë nuk na premton koha me i diskutu, mos të mbeten në seancën e ardhshme prapë të fundit, sepse nuk do t'iu vihet kurr koha që të diskutohen ato pika, por të vendosen në fillim që të shqyrtohen dhe ato kërkesa.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Dua ta shpreh qëndrimin e grupit për tre pika të rendit të ditës. Propozimin që e dha Vetoni që të largohet raporti i kryetarit pasi që as kryetari as nënkryetari nuk janë këtu, është propozim që është i arsyshëm.
Komisioni për emërtimin e rrugëve-nëse vetëm dhe një rrugë është mbetur pa u emërtu dhe nesër na dalin rrugë të reja, atëherë nuk e di ku është problemi pse mu anulu ky komision.
Sa i përket pikës së shfuqizimit të vendimit që e ka marrur kuvendi në lidhje me shkollën në Panorc. Në ligjislaturën e kaluar 3 përfaqësues të partive politke kanë bërë turpin më të madh. Pikërisht mos lejimi për mos me hy në rend të ditës, e kanë sjellë situatën deri këtu. Ajo është pika më e domosdoshme që duhet me nejtë në këtë kuvend. Grupi jonë është kundër heqjes së këytyre dy pikave dhe është pro propozimit të Vetonit që të largohet Raporti i kryetarit.

Argjend Thaçi: Raporti i kryetarit nuk do votohet. Urdhëro,Veton!

Veton Zogaj: Kryesues dhe pse nuk do të votohet si Raport, unë mendoj që shqetësimet tona që do i ngrisim këtu, nuk mundet me i dhënë dikush tjetër, nëse nuk është kryetari dhe mungojnë shumica e drejtorëve, ne duhet të marrim përgjigjje për ato shqetësime.

Argjend Thaçi: Shkojmë ne votim për pikat që duhet të futen në rend të ditës: Formimi i Komisionit për ankesa. Kush është për, që kjo pikë të futet në rend të ditës?
Për: 14
Kundër: 13
Abstenim: 0
Me 14 vota për, 13 kundër dhe asnjë abstenim, kjo pikë futet në rend të ditës.

Kemi dhe propozimin e NISMA-s, për plotësim ndryshimin e vendimit për zëvendësim të Komisionit të Aksionarëve. Kush është për?
Për: 15
Kundër: 0
Abstenim: 13
Me 15 vota për, asnjë kundër dhe 13 abstenime ky plotësim ndryshim, hynë në rend të ditës.
Propozimi i Nebih Bibaj dhe Veton Zogaj që pika 5 shfuqizimi i vendimit nr.02/452 i datës: 22.07.2019 lidhur me kërkesën nr.01/386 të datë: 14.03.2022 të parashtruar nga kryetari i komunës të hiqet nga rendi i ditës. Kush është për, që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës?
Për: 13
Kundër: 15
Abstenim: 0
Me 13 vota për, 15 kundër kjo pikë mbetet si pikë e rendit të ditës.
Shkojmë në votim për propozimin e Nebih Bibaj, që pika 13 të largohet nga rendi i ditës. Kush është për?
Për: 13
Kundër: 15
Abstenim: 0
Me 13 vota për, 15 kundër, kjo pikë mbetet në rend të ditës.
Urdhëro Labinot!

Labinot Gashi: Kërkesa e ime ishte që seanca të shtyhet për shkak të materialit, sepse një material që na ka ardhur në email është i pa lexueshëm. Pa kopje fizike të materialit është problem të bëhesh pjesë e debatit.

Argjend Thaçi: Shkojmë në votim për propozimin e Labinot Gashit që kjo senacë të shtyhet për mungesë të materiali
Për:13
Kundër: 15
Abstenim:0
Me 13 vota për, 15 kundër seanca mbetet që të vazhdojë sot.
Shkojmë në votim për propozimin e Vetonit që të shtyhet Raporti i Kryetarit. Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Unë fillimisht isha që të shtyhet ky Raport, mirëpo mora informacion se deri me 31 mars duhet të bëhet raportimi i kryetarit. Nëse ne e shtyjmë i kalon afati i raportimit. Kush do që ka shqetësime dhe problemet që i kemi ne në mbledhjen e ardhshme, vinë përgjigjijet që i bëjmë.

Aegjend Thaçi: Votohet propozimi i Vetonit, që Raporti i Kryetarit të shtyhet. Kush është për?
Për: 10
Kundër: 15

Abstenim: 0
Me 10 vota për, 15 kundër kjo pikë mbetet si pikë e rendit të ditës. !

Veton Zogaj: Unë bashkë me Muharremin e kam diskutuar në KPF-ë që kuvendi ka të drejtë me themelu komision për shqyrtimin e kësaj draft rregullore.

Argjend Thaçi: Urdhëro,Muharrem!

Muharrem Morina: Përshëndetje për të gjithë! Këto komision për me draftu këtë rregullore e ka formuar kryetari i komunës, Bashkimi është kryetar i komisionit, unë jam antarë dhe Fadil Shala. Dje e kemi pasur debatin publik në pajtim me Udhzimin Administrativ. Unë kam thënë kështu, nuk përjashtohet mundësia nëse ju mendoni që kjo draft rregullore ta ketë një variant tjetër nuk përjashtohet mundësia që ju ta ndryshoni. Ky variant është i formuar prej një kolegjiumi të zyrtarëve ligjor në kuadër të Asosacionit të komunave që është i njëjti në gjitha Republikën e Kosovës. Ne si komision e kemi përshtat me komunën e Malishevës. Komisioni e ka bërë punën e vetë, ndërsa tani është punë e juaja.

Argjend Thaçi: Urdhëro,Nebih!

Nebih Bibaj: Muharrem, ne nuk jemi duke e kontestu punën e juaj por sigurisht hapat i keni pasur të gabum, sepse komisioni është dashur të vijë të themelohet prej kuvendit. Nuk po flasim që komision mbi komision me themelu, mirëpo ky komision fillimisht është dashur të themelohet në kuvend dhe me e trajtu draft rregulloren. Ne kemi nxjerrur komisione brenda kuvendit në të cilën kanë qenë të përfshirë gjitha partit politike dhe i kemi nxjerrur rregulloret, psh njërën nga rregulloret për transparencë kam qenë unë bashkë me zyrën e informimit. Është bërë një punë e mirë, është ardhë në kuvend dhe është votu. Por, vendimi i ardhur në këtë formë sa do që është i drejtë i kryetarit për me themelu një komision, është mirë që të përfshihet dhe kuvendi, sepse kuvendi ka me votu atë rregullore. Unë po mendoj që hapat e parë kanë qenë të gabuar. Komisioni është dashur të themelohet nga kuvendi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina: Komisionin e ka formuar Kryetari komplet brenda ligjit, brenda përgjegjësive ligjore, brenda përgjegjësive që e lejon Ligji për Vëtëqeverisjen Lokale neni 58 paragrafi 8 shkonja H thotë propozon rregullore dhe akte tjera për miratim në Kuvendin Komunal, kjo është baza ligjore me të cilën kryetari ka vepru dhe për kuvend thotë që ju do e shtjelloni nëse ju pelqen ose nuk ju pëlqen varianti juaj është i votimit. Së pari këtë variant keni me gju poshtë, pastaj ju e merrni trajtimin.

Argjend Thaçi: E hedhim në votim propozimin e Vetonit, për formimin e Komisionit. Kush është për?
Për: 3
Kundër: 14

Abstenim: 11
Me 3 vota për, 14 kundër dhe 11 abstenime, propozimi i Vetonit nuk kalon.
Propozimi i fundit është zëvendësimi i Komitetit Planifikim Urban,Kadastër, Turizëm, Mbrojtje të mjedisit me Komitetin për Barazi Gjinore. Kush është për zëvendësimin e këti Komiteti?
Për: 14
Kundër: 13
Abstenim: 1
Me 14 vota për, 13 kundër dhe 1 abstenim kjo pikë futet në rend të ditës. Pikat e ndryshimit vendosen në fund.
Votohet rendi i ditës me ndryshimet e bëra. Kush është për?
Për: 14
Kundër: 12
Abstenim: 0
Me 14 vota për dhe 12 kundër, kalon rendi i ditës. Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Fillimisht humbëm 1 orë që të shtyhen pika të rendit të ditës dhe u bë pshtjellim. Fillimishtë jo pse e propozova unë, por pati propozim konkret që të shtyhet seanca, është dashur kjo të hudhet në votim, e pasaj me largu ose me vendos pika tjera. Unë i ftoj të gjithë ata që mendojnë si ne, mos me qenë pjesë e seancës për arsye që i thashë më lartë.

Grupi nga PDK-ja, grupi nga LDK-ja Labinot Gashi, Zamire Morina, Adile Hoxha, grupi nga VV-ja Veton Zogaj, Arbnore Hoti dhe Valon Krasniqi lëshojnë sallën.

Argjend Thaçi: Prezent në sallë janë 15 asambleistë. Për mungesë të kuorum, ndërprehet seanca.

Mbledhja përfundoi në ora:11:20.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi